



KODI I ETIKES

I

BANKES SE SHQIPERISE

(Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.46, date 25.06.2003)

Tiranë, qershor 2003

...Shkalla e impenjimit të përbashkët ka qenë maksimale. Ajo nuk shpjegohet me interesa financiare të punonjësve dhe as me ambicje për të ngjitur shkallë të hierarkisë... ajo është thjesht pjesë e “çudisë” së mendjes dhe karakterit shqiptar, pjesë e shpirtit dhe e edukatës; pjesë e krenarisë së secilit prej nesh; mbi të gjitha është dashuri për profesionin...

Anëtar i Stafit të Bankës së Shqipërisë

(Konferenca e Parë Kombëtare "Informacioni Statistikor në Shqipëri", 2 - 3 Nëntor 2000)

MISIONI YNË

- Puna me pasion dhe me profesionalizëm për të arritur rezultate sa më të larta e të qëndrueshme.
- Qenia një institucion shembullor dhe i aftë që të tërheqë, të nxisë dhe të edukojë një staf të besueshëm dhe me aftësitë e duhura, i cili të dijë të dëgjojë, të mësojë dhe të realizojë.

PARIMET QË NA UDHËHEQIN

- Përgjegjshmëri për arritjen e rezultateve cilësore në punë.
- Përkushtim dhe pasion për ndershmëri financiare, efektivitet dhe rijësim.

VLERAT TONA BAZË

- Ndershmëri, integritet, besueshmëri.
- Punë e përbashkët në grup e bazuar në sinqeritet dhe në besim reciprok.
- Dhënie mundësi zhvillimi të tjerëve dhe respektimi i diversiteteve.
- Inkurajimi i marrjes përsipër dhe i përballimit të sfidave dhe përgjegjësi.

Pasqyra përmbledhëse e lëndës

1. Çfarë do të kuptojmë me “etikë” dhe me “sjellje etike” në Bankën e Shqipërisë? ...	5
2. Konsiderata të përgjithshme	7
3. Rregullat e etikës për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës	9
3.1. Standardet bazë të sjelljes	10
3.2. Përdorimi dhe përhapja e informacionit	11
3.3. Konfliktet e interesave dhe të tjera	13
4. Rregullat e etikës për anëtarët e stafit	16
4.1. Standardet bazë të sjelljes	17
4.2. Sjellja brenda Bankës së Shqipërisë	20
4.3. Përdorimi dhe përhapja e informacionit	26
4.4. Konfliktet e interesave	29
4.5. Aktivitetet e jashtme dhe të tjera	37

Çfarë do të kuptojmë me “etikë” dhe me “sjellje etike” në Bankën e Shqipërisë?

Etika ndihmon që ju si anëtar i Këshillit Mbikqyrës ose i stafit¹ të Bankës së Shqipërisë të përcaktoni rolin dhe përgjegjësitë si në lidhje me vetveten ashtu edhe me kolegët, me partnerët apo me institucionin ku punoni. Në Bankën e Shqipërisë, etikë do të thotë që ju të:

- Përkrahni si formalisht ashtu edhe shpirtërisht frymën që përçojnë parimet, rregullat dhe udhëzimet që zbatohen në Bankën e Shqipërisë
- Nxisni përgjegjshmërinë.
- Eliminoni mungesën e respektit ndaj të tjerëve, padrejtësitë dhe pandershmëritë.
- Mos jeni indiferent kur iu duhet të përballeni me probleme etike.
- Inkurajoni dialogun, diskutimet e hapura dhe pa paragjykime.
- Punoni me ndershmëri dhe të mësoni nga gabimet.
- Respektoni standardet bazë të sjelljes si brenda ashtu dhe jashtë mjedisit të Bankës së Shqipërisë.
- Jeni krenar për atë që është arritur dhe se si është arritur.
- Jeni modest lidhur me atë që mund të përmirësohet dhe mënyrën se si mund të bëhet ajo.

Sjellja etike nuk është një proces pasiv, por kërkon që ju si anëtar i Këshillit Mbikqyrës apo i stafit të Bankës së Shqipërisë të bëni zgjedhje të ndërgjegjshme, të merrni vendime po të tilla, si edhe të keni gjykim të

¹ Me termin “staf” në Bankën e Shqipërisë do të kuptojmë “personelin” dhe “administratorët” e saj me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

shëndoshë në përputhje me vlerat etike të Bankës së Shqipërisë që materializohen në këtë kod. Gjatë punës tuaj ju duhet të mbani në mendje udhëzimet e mëposhtme bazë:

- Duhet të veproni gjithnjë me ndershmëri, me përkushtim dhe me paanshmëri kur zbatoni detyrat e ngarkuara.
- Asnjëherë nuk duhet të nxirrni apo të përdorni privatisht ndonjë informacion të klasifikuar, të siguruar nëpërmjet punës tuaj për apo në Bankën e Shqipërisë.
- Duhet të shmangni aktivitetet e jashtme, të cilat në mënyrë të arsyeshme mund të perceptohen si konflikt interesash; dhe
- Të trajtoni gjithnjë të tjerët në mënyrë profesionale dhe të edukuar.

Ndonjëherë ju mund të kuptoni se sjellja e përshtatshme në një situatë të dhënë nuk është e qartë. Ky kod mund t'ju ndihmojë ju lidhur me atë që mund të vendosni të bëni në shumë, por jo në të gjitha situatat. Kur ju dyshoni lidhur me implikimet etike të një veprimi, mund të kërkonit këshilla më parë se të veproni. Dhe gjithnjë duhet të pyesni veten (lidhur me veprimet tuaja):

A janë të ligjshme?

A e ndjeni se veproni drejt?

A ndikojnë veprimet e mia negativisht apo pozitivisht tek unë apo tek Banka e Shqipërisë?

Çfarë do të mendonte një person i arsyeshëm lidhur me veprimet e mia?

A do të ndjeheshit ju në pozitë të vështirë nëse të tjerët do të njiheshin me veprimin që po kryeni?

A ekziston ndonjë veprim tjetër, i cili nuk nxjerr në pah një konflikt etik?

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

(A) Ky kod ka si qëllim që të shërbejë si udhëzues për të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe të stafit të Bankës së Shqipërisë lidhur me veprimet e përditshme apo me ato vendimmarrëse në përputhje me Misionin, Parimet që na Udhëheqin dhe Vlerat tona Bazë. Ai nuk pretendon se përmban të gjitha përgjigjet lidhur me çdo problem etik që ju mund të përballeni. Kodi nuk është zëvendësues i gjykimit të shëndoshë dhe nuk eliminon apo mënjanon, rregulloret e ndryshme të zbatuara në Bankën e Shqipërisë. Ai shërben si një urë lidhëse ndërmjet dëshirave dhe veprimeve të përditshme dhe shpreh ndjenjën e angazhimit kundrejt Misionit të Bankës së Shqipërisë. Kodi është, gjithashtu, një mjet për të inkurajuar diskutimet lidhur me etikën dhe për të përmirësuar qëndrimet apo reagimet në punë (ato reagime që lidhen me mëdyshjet dhe paqartësitë etike).

(B) Qëllimet e Bankës së Shqipërisë kërkojnë që gjithkush që punon për këtë institucion, të respektojë apo të zbatojë standardet më të larta të etikës. Ju, si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës ose të stafit, keni përgjegjësi për të kontribuar në qeverisjen e mirë të Bankës së Shqipërisë dhe të ndihmoni në mbajtjen lart të emrit të mirë të saj për ndershmëri, korrektesë, drejtësi, integritet dhe paanshmëri.

(C) Banka e Shqipërisë do të përpiqet të nxisë dhe të mbajë një mjedis pozitiv pune të tillë që të mbështesë sjelljen etike brenda saj. Drejtuesit e Bankës së Shqipërisë do të inkurajojnë në mënyrë aktive dialogun etik, do të ofrojnë drejtim apo këshillim nëpërmjet programeve, materialeve trajnuese apo burimeve të tjera si edhe do të sigurojnë që sistemet, politikat dhe procedurat e brendshme të Bankës së Shqipërisë të jenë në përputhje të plotë me qëllimet etike të këtij institucioni shumë të rëndësishëm.

(D) Moszbatimi i rregullave të kërkuara në këtë Kod dhe i rregullave apo i rregulloreve të Bankës së Shqipërisë të lidhura me të, përbën arsye për veprime disiplinore nga Banka e Shqipërisë. Kur shkeljet konsiderohen serioze mund të shkaktojnë edhe përfundimin e marrëdhënieve me Bankën e Shqipërisë. Gjithkush ka të drejtë që të paraqesë këndvështrimin e tij lidhur me shkakun e përfundimit të marrëdhënieve dhe, në rastin e mosqënies dakord, ka të drejtë të apelojë vendimin përkatës.

(E) Kodi zbatohet tek Këshilli Mbikëqyrës dhe tek i gjithë stafi (administratorët dhe personeli) i Bankës së Shqipërisë, sipas përcaktimit në ligjin për Bankën e Shqipërisë.

RREGULLAT E ETIKËS
PËR
ANËTARËT
E
KËSHILLIT MBIKËQYRËS

KREU I

STANDARDET BAZË TË SJELLJES

1. Parimet bazë të sjelljes

1.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të ndjekin dhe të respektojnë standardet më të larta të të vepruarit etik. Ata duhet të veprojnë me profesionalizëm dhe të vënë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë të gjitha njohuritë e tyre, në mënyrë të ndershme, të pavaruar, të paanshme, pa marrë parasysh interesat personale dhe duke shmangur çdo situatë të prirur për të shkaktuar një konflikt interesash.

1.2 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të trajtojnë me mirësjellje dhe me respekt kolegët e tyre dhe të gjithë stafin e Bankës së Shqipërisë. Ata duhet që nëpërmjet sjelljes së tyre të motivojnë punën dhe përkushtimin e stafit për kryerjen sa më mirë të detyrave të ngarkuara.

1.3 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të marrin parasysh karakterin publik të funksionit të tyre dhe të sillen në mënyrë të tillë që të ruajnë dhe të nxisin besimin në publik lidhur me ta. Ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e detyrave dhe të përgjegjësive të tyre, pasi përfaqësojnë organin më të lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të veprojnë në interesin më të mirë të përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, si dhe të të gjithë sistemit bankar në Shqipëri.

2. Pavarësia

2.1 Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, kur ushtrojnë pushtetet dhe kryejnë detyrat që u janë ngarkuar, nuk duhet të kërkojnë ose të marrin udhëzime nga institucione apo nga organizma të tjerë jashtë Bankës së Shqipërisë. Ata, gjithashtu, nuk duhet të ndikohen nga çdo subjekt tjetër që kërkon të influencojë tek ata për të ndërhyrë në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

2.2 Ndjekja e parimit të pavarësisë të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, është e papajtueshme me kërkimin, me marrjen ose me pranimin nga çdo burim tjetër, të ndonjë përfitimi apo edhe të ndonjë shpërblimi në këmbim të një shume financiare (qoftë edhe në formë dhurate), që mund të jetë përfituar nga ana e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, si pasojë e postit që ai ka në hierarkinë vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë.

2.3 Çdo veprimtari tjetër e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, e cila kryhet jashtë detyrave të tij të përcaktuara në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” nuk duhet të ketë ndikim negativ mbi detyrimet që ai ka ndaj Bankës së Shqipërisë dhe nuk duhet të dëmtojë imazhin e saj. Në artikujt shkencorë ose akademikë, anëtarët

e Këshillit Mbikëqyrës duhet të qartësojnë se artikulli është hartuar personalisht dhe nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Këshillit Mbikëqyrës apo të Bankës së Shqipërisë.

2.4 Marrëdhëniet e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës me grupe që përfaqësojnë interesa të tjerë, nuk duhet të bien ndesh me pavarësinë dhe me integritetin që kërkon pozicioni i tyre në Bankën e Shqipërisë.

KREU II

PËRDORIMI DHE PËRHAPJA E INFORMACIONIT

3. Informacionet jopublike

Sipas nenit 58 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” kërkohet moslejimi i zbulimit ose i publikimit të informacioneve jopublike nga ana e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Kjo duhet të merret parasysh, veçanërisht, në fjalimet apo në deklaratat publike dhe në lidhjet me median përsa i përket vendimeve të politikës monetare, të cilat nuk janë zbuluar ende zyrtarisht për publikun. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që edhe personat, që kanë mundësi njohjeje të informacioneve që ata zotërojnë, të respektojnë detyrimet e përcaktuara në ligj për moszbulimin apo publikimin e informacioneve jopublike.

KREU III

KONFLIKTET E INTERESAVE DHE TË TJERA

4. Konfliktet e interesave

4.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë punonjës, administratorë ose aksionerë me pjesëmarrje ndikuese, në subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm dhe me funksionet e tjera të larta shtetërore si deputet, President dhe anëtar i Këshillit të Ministrave.

4.2 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të evitojnë çdo situatë që përbën shkak për lindjen e një konflikti interesash. Një konflikt interesash lind atëherë kur anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës kanë interesa personale, tregtarë ose jo, të cilët mund të ndikojnë ose duket se ndikojnë në kryerjen e paanshme dhe objektive të detyrave të tyre. Me interesa personale të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të kuptohet krijimi i një përfitimi të mundshëm (potencial) për veten e tyre, për familjet dhe për të afërmit e tjerë të tyre me lidhje gjinie deri në shkallët e përcaktuara në dispozita të veçanta të këtij Kodi.

4.3 Si pasojë e ndikimit të madh që kanë vendimet e Këshillit Mbikëqyrës në zhvillimet e tregut bankar në Shqipëri, anëtarët e tij duhet të veprojnë me pavarësi dhe me paanshmëri të plotë

4.4 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk duhet të përdorin në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo, informacionin jopublik që ata disponojnë për shkak të detyrës, për të kryer apo për të drejtuar transaksione financiare personale, ata vetë apo nëpërmjet palëve të treta.

4.5 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të shmangin çdo lloj pjesëmarrjeje në emërime të strukturave qendrore partiake gjatë kohës që ushtrojnë detyrat e tyre pranë Bankës së Shqipërisë.

4.6 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk duhet që, për një periudhë deri në 1 (një) vit pas përfundimit të mandatit të tyre, të publikojnë informacionet jopublike me të cilat ata janë njohur gjatë kryerjes së detyrës së tyre në Bankën e Shqipërisë

RREGULLAT E ETIKËS

TË

STAFIT

KREU I

STANDARDET BAZË TË SJELLJES

Si anëtarë të stafit të Bankës së Shqipërisë kërkohet që ju të zbatoni standardet më të larta të sjelljes etike në përputhje me vlerat e integritetit, të paanshmërisë dhe të maturisë. Ju duhet të përpiqeni të shmangni qoftë edhe dukjen e të qenurit i pahijshëm në sjelljen tuaj. Gjatë kryerjes së detyrës tuaj, ju jeni të detyruar t'i qëndroni, mbi të gjitha, besnik Bankës së Shqipërisë, objektivave, qëllimeve dhe parimeve të saj.

1. Integriteti

1.1 Kërkohet që ju të veproni me integritet gjatë gjithë veprimtarisë tuaj zyrtare dhe të shmangni çfarëdolloj sjelljeje që mund të paraqesë ndryshe ju ose Bankën e Shqipërisë. Në Bankën e Shqipërisë me integritet do të kuptohet ndershmëri, korrektesë, drejtësi dhe besnikëri kundrejt punës dhe institucionit. Ju duhet t'i ofroni Bankës së Shqipërisë një informacion të plotë dhe të saktë lidhur me gjithçka nevojitet për administrimin e çështjeve të stafit. Ju duhet të

raportoni në mënyrë të menjëhershme ndryshimet në rrethanat tuaja personale, të cilat mund të prekin nivelin tuaj të treguar të përfitimeve.

1.2 Banka e Shqipërisë respekton intimitetin tuaj dhe nuk dëshiron që të ndërhyjë në jetën tuaj personale apo në sjelljet tuaja brenda dhe jashtë vendit të punës. Sidoqoftë, statusi juaj si anëtarë të stafit të Bankës së Shqipërisë ka si pasojë disa detyrime lidhur me sjelljen tuaj, si në punë ashtu edhe jashtë saj. Banka e Shqipërisë i kushton rëndësi të madhe zbatimit, nga ana juaj, të të gjitha akteve ligjore e nënligjore në fuqi, sikurse edhe shmangies së veprimeve që mund të perceptohen si shpërdorim i prestigjit që ka Banka e Shqipërisë dhe stafi i saj; shkujdesjet në këtë drejtim do të reflektohen në marrëdhëniet tuaja me Bankën e Shqipërisë.

1.3 Banka e Shqipërisë do të jetë, gjithashtu, e vëmendshme lidhur me sjelljet tuaja të pahijshme, botërisht të shprehura, lidhur me dhunën në familje apo me abuzimin me anëtarët e familjes.

1.4 Banka e Shqipërisë nuk ka detyrimin që të hetojë thëniet ose pohimet, se ju keni shkelur ligjet. Por, nëse shqetësimet lidhur me sjelljen tuaj jashtë vendit të punës janë përçuar në vëmendjen e saj nga një palë e tretë, Banka e Shqipërisë do t'ju bëjë me dije (në rastet kur kjo është e mundur) lidhur me problemin në fjalë.

1.5 Nuk është detyrë e Bankës së Shqipërisë që të përcaktojë se nëse ju keni shkelur apo jo ligjet në fuqi; kjo i përket gjykatës. Sidoqoftë, nëse Banka e Shqipërisë merr një urdhër për të përmbushur një detyrim ligjor nga gjykata apo nga çdo autoritet tjetër, që ka forcën ekzekutive të një detyrimi lidhur me mbajtjen e një pjese të pagës së një anëtari të stafit të saj, ajo do ta zbatojë atë.

2. Paanshmëria

Ju si anëtar i stafit të Bankës së Shqipërisë duhet të veproni me paanshmëri. Ju duhet të tregoni kujdes që shprehja e pikëpamjeve dhe e bindjeve tuaja personale, të mos kompromentojë apo të duket se kompromenton rezultatet e detyrave të ngarkuara apo interesat e Bankës së Shqipërisë. Sjellja juaj zyrtare duhet të karakterizohet gjithnjë nga objektiviteti dhe profesionalizmi. Ju nuk duhet të lejoni që marrëdhëniet apo konsideratat personale, përfshirë këtu edhe paragjykimet, njëanshmëritë apo favoritizmat, të ndikojnë rezultatet e detyrave tuaja zyrtare. Njëllor duhet t'i shmangeni edhe situatave që krijojnë konflikte interesash.

3. Maturia

Ju si anëtar i stafit të Bankës së Shqipërisë duhet të tregoni maturinë më të madhe gjatë veprimeve tuaja, të keni takt dhe të jeni i rezervuar në deklaratimet që bëni në përputhje me statusin tuaj në Bankës së Shqipërisë. Ju duhet t'i shmangeni pjesëmarrjes në çdo aktivitet që është në kundërshtim me interesat e Bankës së Shqipërisë apo që mund të dëmtojë reputacionin e saj. Ju duhet të respektoni dhe të ruani sekretin e informacionit të mësuar apo të vënë në dispozicion tek ju, si pasojë e pozicionit në hierarkinë zyrtare apo të qenurit staf i Bankës së Shqipërisë.

KREU II

SJELLJA BRENDIA BANKËS SË SHQIPËRISË

Vlerat bazë të paanshmërisë, të integritetit dhe të maturisë duhet të udhëheqin të gjitha aspektet e sjelljes suaj gjatë punës.

4. Detyra për të qenë besnikë ndaj institucionit

Ju duhet të respektoni pozicionin tuaj dhe të jeni i pavarur, duke mos pranuar asnjë udhëzim lidhur me performancën e detyrave tuaja zyrtare nga asnjë burim tjetër jashtë Bankës së Shqipërisë. Duke pranuar punësimin në Bankën e Shqipërisë ju, sikurse çdo anëtar tjetër i stafit, keni premtuar që të hiqni dorë nga detyra juaj vetëm nën autoritetin e administratorëve dhe të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

5. Paraqitja në punë, mirësjellja dhe respekti

5.1 Paraqitja juaj në punë duhet të jetë përshtatshme dhe e tillë që të shprehë:

- a) kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm për anën tuaj pamore;

- b) nivelin e domosdoshëm të pastërtisë tuaj personale;
- c) plotësimin e kërkesave të domosdoshme të veshjes tuaj në ambientet e Bankës sipas rregullave në fuqi;
- d) vëmendje në mënyrën e komunikimit dhe të qëndrimit në ambientet e Bankës.

5.2 Ju duhet t'i trajtoni kolegët tuaj (qofshin këta eprorë, të barabartë apo vartësit tuaj) me mirësjellje dhe respekt, dhe nuk mund t'i ngacmoni ata (fizikisht apo me fjalë). Gjatë punës, ju duhet që gjithnjë të shmangni edhe ato sjellje, që megjithëse nuk arrijnë në nivelin e ngacmimit apo të abuzimit, mund të krijojnë një atmosferë jomiqësore apo frike.

5.3 Do të konsiderohen si ngacmime dhe do të trajtohen si të tilla të gjitha ato fjalë apo sjellje që ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme në punën e gjithkujt apo që krijojnë një mjedis pune frikësues (kërcënues), jomiqësor dhe fyes. Një vend pune i hapur dhe i besueshëm është thelbësor për efektivitetin e punës tuaj në Bankën e Shqipërisë si edhe për të ruajtur moralin e stafit.

5.4 Do të konsiderohen si ngacmime seksuale dhe do të trajtohen si të tilla të gjitha përpjekjet (avancimet) e padëshiruara seksuale, kërkesat për favore seksuale, ose të tjera sjellje (fizike ose me fjalë) me natyrë seksuale të cilat ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme me punën, kushtëzojnë punësimin apo krijojnë një mjedis pune fyes, jomiqësor apo frikësues.

6. Diversiteti

Si pasojë e karakterit demokratik që ka Banka e Shqipërisë dhe e vlerës që kjo e fundit i jep diversitetit, duhet që ju të veproni me tolerancë, me ndjeshmëri,

me respekt dhe me paanësi kundrejt kulturës dhe formimit të personave të tjerë, që nuk i kanë ato të njëjta me ju. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë reagon ndaj çdo sjelljeje abuzive, e cila do të konsiderohet fyese për ambientin apo për persona konkretë.

7. Përgjegjësia

Ju duhet që gjithmonë të mos dilni jashtë autoritetit që ju jep funksioni. Ju mbeteni përgjegjës për detyra që i delegoni të tjerëve dhe pritet që ju të ushtroni mbikëqyrje dhe kontroll të përshtatshëm mbi gjithçka që lidhet me detyrën tuaj.

8. Përdorimi i pronave, i pajisjeve dhe i burimeve të Bankës së Shqipërisë

8.1 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, ju duhet të mbronni dhe të ruani pronën e Bankës së Shqipërisë. Nuk lejohet që ju, drejtpërsëdrejti ose jodrejtpërsëdrejti, të përdorni apo të lejoni që të përdoret prona, që Banka e Shqipërisë zotëron ose ka në përdorim, për qëllime të tjera, përveçse për kryerjen e punës. Me pronë të Bankës së Shqipërisë, kuptohet çdo pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme që ka në përdorim, në gëzim dhe në disponim Banka e Shqipërisë.

8.2 Ju keni përgjegjësinë që të siguroheni se burimet e Bankës së Shqipërisë po përdoren për realizimin e detyrave zyrtare të saj. Gjithashtu, në funksion të përdorimit sa më efikas të burimeve që ju janë vënë në dispozicion, ju duhet që

t'i kushtoni kohën tuaj të punës vetëm aktiviteteve zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

8.3 Banka e Shqipërisë mund të lejojë përdorimin e pronave dhe të pajisjeve të saj për përdorim personal të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të stafit, në rastet kur e gjykon të arsyeshme që ta bëjë këtë.

9. Zgjidhja e problemeve dhe e konflikteve personale

9.1 Drejtuesit përkatës, kanë përgjegjësi që të jenë të disponueshëm për anëtarët e stafit, të cilët duan të ngrenë çështje apo shqetësime në konfidencë (vetëm për vetëm) dhe t'i trajtojnë me ndjeshmëri dhe paanshmëri situata të tilla.

9.2 Drejtuesit përkatës duhet të krijojnë një atmosferë, ku anëtarët e stafit të ndjehen të lirë të përdorin (pa patur frikë për ndëshkime), rrugët institucionale ekzistuese për zgjidhjen e problemeve apo të konflikteve të çdo lloji, si edhe të shprehin shqetësime lidhur me situatat problematike apo konfliktuale ku ndodhen ose ku mund të ndodhen, jo vetëm lidhur me marrëdhëniet e tyre brenda Bankës së Shqipërisë.

10. Hakmarrja

10.1 Dëmtimi që pësohet si rezultat i akuzave të pabazuara dhe joserioze dekurajon stafin lidhur me sjelljen dhe me zbatimin e standardeve të larta etike. Si pasojë, Banka e Shqipërisë mbron stafin e saj në rastet kur ata bëhen objekt

i akuzave të pabaza nga çdokush që mbetet i pakënaqur si pasojë e kryerjes së rregullt të detyrës prej tyre.

10.2 Liria dhe përgjegjësia për të ngritur probleme, çështje apo shqetësime është thelbësore për të fuqizuar stafin dhe për të ruajtur integritetin si institucion. Si pasojë, Banka e Shqipërisë do të mbrojë stafin nga hakmarrjet e çdo lloji përfshirë edhe ato të ardhura si pasojë e qëndrimeve të mbajtura në rastin e ngritjes së problemeve dhe të shqetësimeve të ndryshme. Kjo përgjegjësi për të mbrojtur anëtarët e stafit brenda saj zbatohet lidhur me persona, të cilët cënojnë ose aplikojnë hakmarrjen kundër stafit të saj gjatë zbatimit të detyrave. Ankesat për hakmarrje trajtohen seriozisht dhe sqarohen menjëherë.

11. Intimiteti

11.1 Banka e Shqipërisë respekton intimitetin e stafit. Informacionet konfidenciale (përfshirë dosjet personale, shënimet mjekësore, informacione lidhur me hetime të ndryshme, si dhe masat disiplinore), nuk do të lejohet që të keqpërdoren, nuk do të zbulohen dhe do të lejohet që të njihen vetëm nga persona të autorizuar. Banka e Shqipërisë ruan konfidencialitetin e çdo informacioni në përputhje me aktet perkatese nenligjore të nxjerra prej saj.

11.2 Banka e Shqipërisë respekton intimitetin tuaj në punë dhe nuk do të kërkojë që të ndryshojë sjelljet tuaja personale deri kur këto sjellje nuk do të dëmtojnë rezultatet e punës, apo kur do të jenë në kundërshtim me “Rregullat mbi marrëdhëniet e punës të personelit në Bankën e Shqipërisë”.

12. Ekuilibri Punë-Familje

Banka e Shqipërisë respekton ekuilibrin punë-familje si një sfidë për arritjen e objektivave të paracaktuar dhe çmon përpjekjet dhe pasionin tuaj për ruajtjen e këtyre raporteve. Banka e Shqipërisë do të përpiqet që të krijojë një mjedis të brendshëm sa më të mirë që të jetë e mundur, në mënyrë që t'ju mbështesë ju për të arritur një ekuilibër sa më të efektshëm ndërmjet punës, jetës familjare dhe asaj personale.

KREU III

PËRDORIMI DHE PËRHAPJA E INFORMACIONIT

13. Përdorimi dhe përhapja e informacioneve të klasifikuara

13.1 Ju keni përgjegjësi të mbronni sigurinë e çdo informacioni të klasifikuar, të siguruar në Bankën e Shqipërisë apo të prodhuar prej saj. Për këtë arsye, që të shmangni çdo përhapje të paautorizuar të informacionit, ju duhet të jeni të kujdesshëm në mënyrën se si e përdorni atë. Parimi bazë i rregullave dhe i udhëzimeve lidhur me sigurinë e informacionit është se informacioni i klasifikuar mund të komunikohet tek anëtarët e stafit vetëm në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” apo me aktet rregullative që lidhen me klasifikimin e informacioneve sekrete dhe konfidenciale në Bankën e Shqipërisë.

13.2 Nuk lejohet marrja dhe dhënia e informacionit, për përfitime të ndryshme ose kur përbën shkak për lindjen e konfliktit të interesave gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë.

13.3 Ju, gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë nuk duhet që në mënyrë të paautorizuar me ligj ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Banka e Shqipërisë është palë:

- a) të lejoni zbulimin ose publikimin e informacioneve jopublike, të cilat ju i keni përfituar nga kryerja e detyrave tuaja;
- b) të përdorni apo të lejoni që ky informacion të përdoret për përfitime personale.

14. Marrëdhëniet me median, deklaratimet publike dhe publikimet

14.1 Nëse nuk jeni të autorizuar ju nuk duhet që të jepni, të publikoni apo të nxirrni për përdorim publik materiale që kanë të bëjnë me politikën ose me aktivitetet e Bankës së Shqipërisë apo me çfarëdolloj çështjeje tjetër që lidhet me të dhe që nuk klasifikohen si informacione për publikim. Ndërkohë që ju duhet të shmangni çfarëdolloj sjelljeje në publik që mund të interpretohet apo të lidhet, në ndonjë mënyrë, me pozicionin tuaj në Bankën e Shqipërisë. Statusi i një të punësuarit në Bankën e Shqipërisë kërkon rezervim dhe takt.

14.2 Brenda Bankës së Shqipërisë saktësohen procedura të veçanta lidhur me mundësinë e kontakteve me mediat. Më parë se t'i përgjigjeni apo të bëheni nismëtarë të një kontakti me shtypin lidhur me politikën apo me aktivitetet e Bankës së Shqipërisë, apo për ndonjë çështje tjetër lidhur me të, ju duhet të këshilloheni me eprorin tuaj, i cili, si rregull, duhet të këshillohet me personin e autorizuar për komunikimin me median, më parë se sa ju të lejoheni që të realizoni kërkesën tuaj.

14.3 Banka e Shqipërisë është pronare e të drejtës së të gjitha materialeve të shkruara që ju prodhoni gjatë kryerjes së detyrës tuaj zyrtare dhe ka të drejtën që ta publikojë një punë të tillë në atë mënyrë që ajo e shikon të përshtatshme. Nëse Banka e Shqipërisë nuk e shikon të arsyeshme që të publikojë punimin tuaj, ju mundeni, me miratimin e eprorit tuaj dhe të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun ta publikoni diku tjetër atë. E njëjta mënyrë miratimi kërkohet për punime të përgatitura gjatë kohës tuaj të lirë ose më parë se ju të ishit staf i Bankës së Shqipërisë, nëse tema e punimit tuaj lidhet me Bankën e Shqipërisë ose me aktivitetet e saj.

KREU IV

KONFLIKTET E INTERESAVE

15. Konfliktet e interesave

15.1 Me konflikt interesi, kuptohet konflikti ndërmjet interesit privat dhe interesit publik të stafit gjatë marrëdhënieve juridike të punës në Bankën e Shqipërisë.

15.2 Ju duhet të veproni gjithnjë në interes të Bankës së Shqipërisë dhe në mbështetje të Misionit të saj. Si të tillë ju duhet të shmangni konfliktet – apo qoftë dhe shfaqjen e tyre – ndërmjet interesave dhe përgjegjësive tuaja të ardhura si pasojë e qënies staf i Bankës së Shqipërisë.

15.3 Konflikti i interesit, kur ekziston, mund të rezultojë i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë. Konflikti i interesit gjatë marrëdhënieve tuaja të punësimit në Bankën e Shqipërisë, është konflikti që kërcënon interesin publik nëpërmjet zëvendësimit të tij nga interesi privat.

15.4 Konflikte potenciale interesash ka shumë. Pa paragjykuar disiplinën e kërkuar në rregullat e zbatueshëm tek stafi i Bankës së Shqipërisë, disa nga tipat e interesave që krijojnë konflikte mund të jenë ata të paraqitur në vijim:

- 1) Interesa, të cilët klasifikohen sipas përcaktimeve ligjore lidhur me deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve.
- 2) Çdo lloj interesi tregtar ose jotregtar, i deklaruar nga ju në Bankën e Shqipërisë.
- 3) Interesa të tjerë të përcaktuar me akte nënligjore të dalë në zbatim të këtij ligji.
- 4) Interesa tregtar ose jotregtar që ju keni në:
 - a- -subjekte juridike fitimprurëse ose jofitimprurëse, në të cilat ju shërbeni si konsulent, si ortak, si përfaqësues apo agent etj.;
 - b- -subjekte juridike me të cilat ju negocioni ose keni rënë dakord për një punësim apo angazhim kontraktor ose jokontraktor të ardhshëm tuajin.

15.5 Gjatë punësimit në Bankën e Shqipërisë, ju mund t'ju lindin apo të përfitoni të drejta pasurore ose interesa, që mund t'ju pengojnë apo që mund të bëhen shkak për lindjen e konflikteve në zbatimin e detyrës tuaj. Në rast se këta interesa klasifikohen si të tillë dhe ju kërkohet që të hiqni dorë prej tyre, ju duhet t'i bindeni kësaj kërkesë. Në rast të kundërt, konflikti i interesave zgjidhet nëpërmjet transferimit në një vend tjetër pune ose nëpërmjet ndërprerjes së marrëdhënieve juridike të punës.

15.6 Në çdo rast që krijohen rrethana në të cilat, ushtrimi i detyrës bëhet i pamundur për shkak të konfliktit të interesave për ju vetë apo për personat e lidhur me ju, ju duhet të informoni me shkrim eprorët tuaj dhe Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Juridik.

15.7 Verifikimi i situatave të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesash sipas përcaktimit të pikës “15.6” bëhet nga një komision i caktuar

nga Guvernatori. Ky komision përpilon raportin për kualifikimin e rrethanave përkatëse (nëse përbëjnë ose jo konflikt interesash) dhe e paraqit më pas tek Guvernatori.

15.8 Ju duhet të shmangni jo vetëm çdo rrethanë që krijon konflikt interesash por edhe ato që mund të krijojnë dukjen e ndonjë konflikti të këtij lloji. Nëse shfaqen situata që mund të sjellin dukjen e një konflikti të tillë, ju duhet të bëni me dije në mënyrë të menjëhershme dhe të plotë eprorët, si dhe t'u kërkonti mendim lidhur me menjanimin e vetvetes prej tyre.

15.9 Nëse ju jeni i aktivizuar në aktivitetet prokuruese të Bankës së Shqipërisë dhe nëse ju keni planifikuar apo keni ndërmend të planifikoni, ndonjë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të jashtëm, financiar apo të një natyre tjetër, i cili është apo mund të duket si konflikt interesash me ato të Bankës së Shqipërisë, ju duhet të deklaroni këtë situatë tek eprorët dhe të kërkonti mendimin e tyre, nëse duhet të tërhiqeni apo jo nga pjesëmarrja në aktivitetin prokurues.

16. Interesat financiarë personalë

16.1 Në përgjithësi, ju jeni i lirë që të kujdeseni për interesat personalë financiarë ashtu si e shikoni të arsyeshme ju vetë, me përjashtim të rasteve në vijim:

- a) Meqënëse Banka e Shqipërisë ka si rol edhe mbikëqyrjen e kursit të këmbimit, ju e keni të ndaluar që të përfshiheni në tregti afatshkurtër (për shembull, kombinim blerje-shitje brenda një periudhe gjashtëmujore) ari, monedhe të huaj apo mjetesh financiare me lidhje të drejtpërdrejtë me to, për qëllime spekulimi. Termi “kombinim” nuk përfshin transaksione në

një drejtim, si për shembull vetëm shitje ose vetëm blerje të monedhës së huaj për arsye të ndryshme;

- b) ju e keni të ndaluar që të përdorni ose të furnizoni të tjerët me informacione të rezervuara, me të cilat jeni njohur për shkak të pozicionit zyrtar, për qëllime që kanë lidhje me transaksionet tuaja private financiare.

16.2. Meqënëse ka shumë situata kur mund të verifikohet paragrafi “16.1.b” dhe interpretimet e tij mund të jenë të shumta, më poshtë jepen udhëzime të tjera lidhur me të. Nëse ju nuk jeni të sigurtë se si duhet të veproni në situata të caktuara ju duhet të kërkonti ndihmën e specialistit të caktuar për këtë punë.

- a) Informacionet e rezervuara, të mbetura pezull, përfshirë edhe ato ndaj të cilave tregu është i ndjeshëm e që lidhen me veprime të Bankës së Shqipërisë, kur zbulohen, ka shumë mundësi që të kenë një ndikim material në tregun e valutës apo në mjetet e tjera të investimit. Raste të këtyre informacioneve ndaj të cilëve tregu është i ndjeshëm, mund të jenë ato që lidhen me kursin e këmbimit, me ndryshimin e normave të interesit; me iniciativa apo me ndryshime të rëndësishme në politikat ekonomike ose në ato fiskale.
- b) Ndalimet e mësipërme zbatohen lidhur me transaksionet financiare të kryera nga ju vetë dhe nga anëtarët më të afërt të familjes (bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët dhe ata që varen ekonomikisht prej jush).

16.3 Të drejtat e pronësisë mbi aksionet apo mbi letrat e tjera me vlerë, konsiderohen në interesin tuaj privat dhe të personave të tjerë të lidhur me ju, kur:

- a) ju përket e drejta e pronësisë si ortak në shoqëri tregtare;
- b) jeni zotërues i bonove të privatizimit (të cilat duhet t'i përdorni vetëm sipas përcaktimeve ligjore).

16.4 Nëse ju jeni punonjës i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë dhe zotëroni, drejtpërsëdrejti apo jodrejtpërsëdrejti, aksione apo letra të tjera me vlerë të ndonjë banke të licencuar ose institucioni tjetër financiar, ju duhet të tërhiqeni nga shqyrtimi ose nga pjesëmarrja në çdo problem rregullator dhe mbikëqyrës që lidhet me to.

16.5 Nëse ju jeni punonjës i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, nuk lejohet që të rekomandoni ose të sugjeroni drejtpërsëdrejti apo jodrejtpërsëdrejti blerjen, shitjen apo çfarëdolloj kalimi të pronësisë të aksioneve apo të letrave me vlerë të ndonjë banke të licencuar ose të ndonjë institucioni tjetër financiar, që në ndonjë mënyrë ka lidhje me punën tuaj

16.6 Kur krijohet një marrëdhënie e tillë (sipas përcaktimit të paragrafit 16.5 dhe 16.6), ju duhet të informoni me shkrim eprorin tuaj të drejtpërdrejtë dhe Departamentin Juridik dhe të Burimeve Njerëzore. Në raste të tilla Administratorët e Bankës së Shqipërisë shprehen me vendim për ndryshimin e vendit të punës.

16.7 Të drejtat e pronësisë mbi letrat me vlerë, nuk konsiderohen në interesin tuaj privat si punonjës i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë dhe të personave të tjerë të lidhur me ju kur pronësia buron nga investimi në një fond investimi me pjesëmarrje të gjerë ose fond tjetër investimi kolektiv, që është publikisht i tregtueshëm ose gjerësisht i shpërndarë.

16.8 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, juve nuk ju lejohet të merrni kredi të çdo lloji nga ndonjë bankë e licencuar ose nga ndonjë institucion tjetër financiar, që kryen veprimtari bankare, me kushte që janë favorizuese për shkak të detyrës. Në rastet kur puna juaj në Bankë e lejon një

mundësi të tillë, ju duhet të jeni shumë të kujdesshëm gjatë kryerjes së saj (punës), në mënyrë që çdo marrëdhënie e sipërpërmendur (kredi) e shfrytëzuar prej jush, të mos mund të klasifikohet si përfitim për shkak të detyrës.

16.9 Në qoftë se jeni punonjës në Departamentin e Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, nuk ju lejoheq të rekomandoni ose të sugjeroni, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, dhënien apo marrjen e kredive nga ndonjë bankë e licencuar apo institucion tjetër financiar, që kryen veprimtari bankare.

16.10 Ju, gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, mund t'ju lejoheq të merrni kredi konsumatore, për strehim ose për përmirësimin e kushteve të jetesës, nga bankat e licencuara apo nga institucionet e tjera financiare që kryejnë veprimtari bankare nëpërmjet mjeteve të tilla si kartë krediti, vetëm nëse :

- a) kredia nuk është marrë me kushte dhe afate më të favorshme se ajo që i ofrohet publikut në përgjithësi;
- b) ju i plotësoni punëdhënësit një deklaratë për tërheqjen tuaj nga shqyrtimi ose nga pjesëmarrja në çdo problem mbikëqyrës dhe rregullator, që ka lidhje me bankën.

16.11 Në qoftë se jeni punonjës në Departamentin e Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, ju mund të kërkoni leje nga Administratorët e Bankës së Shqipërisë për të rinovuar ose për të rinegociuar kredinë e marrë. Kjo kërkesë përmban:

- a) qëllimin e rinovimit dhe të rinegociimit;
- b) afatet dhe kushtet e kredisë fillestare;
- c) afatet dhe kushtet e reja që ju ofrohen dhe si janë ato në krahasim me afatet dhe me kushtet e kredive, që ofrohen nga bankat për konsumatorët e zakonshëm;
- d) krahasimin me praktika të kredisë për kreditorët e zakonshëm të cilëve

nuk iu refuzohet e drejta për të marrë kredi në rrethana të ndryshme nga ato tuajat;

e) rrethana të tjera, që mund të zbatohen për kërkesën.

16.12 Ju, si punonjës në Bankën e Shqipërisë, mund ta rinovoni ose rinegocioni me miratim paraprak të Guvernatorit një kredi të përfituar gjatë marrëdhënieve të mëparshme të punësimit në institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

17. Detyrimi për të deklaruar informacione mbi veten

17.1 Ju duhet të tregoni çdo interes biznesor apo financiar që keni ju apo një anëtar i afërt i familjes suaj (sipas përcaktimit në pikën 22.1), i cili mund të jetë në konflikt të dukshëm me detyrat që ju keni në Bankën e Shqipërisë. Ju duhet të deklaroni gjithçka tek eprori juaj ose tek personi i caktuar zyrtarisht për probleme të tilla. Eprorët ose zyrtarët përkatës duhet të bëjnë një material të shkruar mbi këto informacione për të vërtetuar deklarin e bërë nga punonjësi në fjalë.

17.2 Nëse ju jeni të pasigurtë lidhur me faktin se sa përputhet informacioni i deklaruar prej jush me atë që ju detyroheni të deklaroni, duhet të kërkonit shpjegime të mëtejshme në Departamentin e Burimeve Njerëzore. Banka e Shqipërisë, mund të kërkojë që disa kategori të stafit të saj, të deklarojnë në mënyrë periodike dhe konfidenciale (të rezervuar) në dosjen e tyre të gjitha aktivitetet dhe interesat financiarë sipas një forme (modeli) të miratuar paraprakisht. Këto deklarime analizohen nga një person i ngarkuar nga Guvernatori.

KREU V

AKTIVITETET E JASHTME DHE TË TJERA

18. Punësimi jashtë Bankës së Shqipërisë

18.1 Ju nuk mund të përfundoni marrëdhënie punësimi tjetër, pavarësisht nëse është me shpërblim ose jo, pa miratimin paraprak, me shkrim, të Administratorëve të Bankës së Shqipërisë.

18.2 Me miratim të Administratorëve të Bankës së Shqipërisë, ju gjatë marrëdhënieve të punësimit, mund t'ju lejohet të angazhoheni në veprimtari jashtë Bankës së Shqipërisë, me shpërblim apo pa shpërblim, në rastet:

- 1) Kur emëroheni si anëtar në organet kolegjale të institucioneve shtetërore ose në organizma të tjerë publikë.
- 2) Kur angazhoheni për mbajtje fjalimesh, për dhënie leksionesh, për mësimdhënie apo për shkrime që kanë lidhje me punën tuaj. Mësimdhënia, leksionet, fjalimet apo shkrimet, kanë lidhje me punën (shërbimin) tuaj atëherë kur:

- a) këto veprimtari kryhen si pjesë e veprimtarisë suaj zyrtare;
- b) ftesa për t'u marrë me këto veprimtari, ju bëhet, kryesisht e në rradhë të parë, për shkak të pozicionit në Bankën e Shqipërisë;
- c) ftesa ose oferta për shpërblim bëhet nga personi apo subjekti interesi i të cilit lidhet me punën tuaj;
- d) informacioni që ju jepni, është kryesisht jopublik;
- e) subjekti që trajtohet lidhet ngushtë me punën që ju kryeni aktualisht ose keni kryer deri një vit më parë;
- f) subjekti që trajtohet lidhet ngushtë me ndonjë program apo veprimtari të shpallur ose në vazhdim të Bankës së Shqipërisë.

19. Aktivitete të tjera të jashtme

19.1 Ju duhet të kërkonti lejen e Bankës së Shqipërisë për të patur një punësim, aktivitet biznesi apo profesion të lirë jashtë saj. Banka e Shqipërisë nuk do të kundërshtojë një aktivitet të tillë i cili:

- a) nuk ndërhyt në aftësinë tuaj për të bërë në rregull punën në Bankën e Shqipërisë;
- b) është në përputhje me rregullat e Bankës së Shqipërisë lidhur me sjelljen e stafit të saj;
- c) nuk krijon konflikt interesash.

19.2 Kërkesa juaj për të ushtruar një aktivitet të jashtëm duhet të jetë e qartë dhe duhet t'i dërgohet Departamentit të Burimeve Njerëzore së bashku me miratimin e eprorit tuaj. Në disa raste, veçanërisht për aktivitete që lidhen me fjalime apo me publikime jashtë Bankës së Shqipërisë, kërkesa juaj ka nevojë që të bëhet e qartë edhe për Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun.

19.3 Ju mund të merrni pjesë në aktivitete vullnetarë të një bashkësie të caktuar apo në të tilla me karakter bamirës pa patur një pëlqim paraprak. Sidoqoftë, nëse ju keni dyshime që një aktivitet ku ju keni ndërmend të merrni pjesë mund të jetë në kundërshtim me kriteret e sipërpërmendura, ju duhet të konsultoheni në njësinë përkatëse që monitoron zbatimin e marrëdhënieve etike para se të merrni pjesë në të.

20. Aktivitetet politike

Ju duhet të kërkonti leje për aktivitete politike, për dhënie të kontributeve politike, me përjashtim të aktiviteteve të tilla sikurse janë votimi. Nuk lejohet që ju të merrni pjesë në organizimin apo drejtimin e aktiviteteve politike. Ju nuk duhet të konkurrioni për poste publike të zgjedhur apo politike pa marrë leje më parë. Nëse ju pranoni një emërim politik në strukturat qendrore partiake ju duhet të paraqisni dorëheqjen si anëtar i stafit të Bankës së Shqipërisë.

21. Dhuratat, argëtimet, shpërblimet për punonjësit

21.1 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, nuk lejohet që ju të kërkonti ose të pranoni, drejtpërsëdrejti ose jodrejtpërsëdrejti, dhurata, shpërblime, favore, argëtime, kredi, hua ose çdo gjë tjetër, që ka vlerë monetare, nga persona ose subjekte që :

- a) kanë ose që kërkojnë të sigurojnë përfitime në procedurat administrative, në marrëdhëniet kontraktore ose në çdo marrëdhënie tjetër financiare me Bankën e Shqipërisë;
- b) kryejnë transaksione ose veprimtari të cilat mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë;

- c) kanë interesa që preken në mënyrë thelbësore nga kryerja ose nga moskryerja e detyrave zyrtare të punonjësit të Bankës së Shqipërisë.

21.2 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, ju mund të pranoni artikuj ushqimorë në vlerë të vogël në raste jo të shpeshta. Përfitime të tilla lejohen edhe kur ofrohen në mbledhje, dreka ose darka, si pjesë e programit të veprimtarive të organizuara nga Banka e Shqipërisë.

21.3 Ju nuk duhet asnjëherë që të kërkonit dhurata ose favore që kanë lidhje me detyrat tuaja në Bankën e Shqipërisë. Si rregull, dhuratat që ofrohen, nuk duhen pranuar. Mund të pranohet një dhuratë e vogël simbolike, reklamuese ose inkurajuese. Por vlera e saj nuk duhet të jetë qartësisht më tepër se dhjetë mijë lekë. Në të tilla raste ju mund ta mbani dhe të mos e deklaroni atë. Nëse vlera e dhuratës mund të jetë më e madhe se dhjetë mijë lekë, ajo duhet të deklarohet së bashku me vlerën, e përafërt të saj. Dhurata mund të kthehet mbrapsht për një vlerësim nëse ka pikëpyetje lidhur me vlerën e saj.

21.4 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, nuk lejohet që ju të kërkonit kontribute nga punonjësit e tjerë për të bërë dhuratë për një epror, dhënien e donacionit për këtë të fundit ose të pranoni dhuratë nga punonjësi me pagë më të vogël.

21.5 Lejohet që ju të merrni dhurata spontane të dhëna me dëshirë për rastet e veçanta si martesë, ditëlindje, dalje në pension, përfundim mandati ose raste ngushëllimi për vdekje apo për sëmundje. Këto lloj dhuratash si rregull, kufizohen vetëm në rrethin e ngushtë të bashkëpunëtorëve. Nuk lejohet që eprorët të kërkojnë kontribute nga punonjësit që janë nën mbikëqyrjen e tyre për çfarëdolloj rrethanash.

22. Nepotizmi

22.1 Punonjësit, të cilët ata vetë ose bashkëshortët e tyre janë gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve a të motrave) ose krushqi e afërt (vjuhërr, dhëndër, nuse, kunat, kunatë, thjeshtër, njerë e njerë), nuk lejohen të punojnë në Bankën e Shqipërisë. Përfshihen nga kjo dispozitë personat, të cilët kanë lidhje në raportet e lartpërmendura dhe aktualisht janë të punësuar në Bankën e Shqipërisë.

22.2 Nëse ju keni lidhje gjinie ose krushqie në raportet e përcaktuara në pikën 22.1 të këtij neni dhe jeni aktualisht të punësuar në Bankën e Shqipërisë, nuk lejohet që të punoni në ato njësi organizative:

- a) që kanë lidhje të vazhdueshme në ekzekutimin, procedimin dhe përfundimin e operacioneve të punës në Bankën e Shqipërisë;
- b) që nëpërmjet lidhjeve të sipërpërmendura të mund të krijojnë lehtësira, përfitime apo kushte përfitimi siç përcaktohet në këto rregulla.

22.3 Ju, gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, nuk lejohet të rekomandoni apo të ndikoni në procedurat e rekrutimit (punësimit) të stafit në Bankën e Shqipërisë, kur vendi i punës kushtëzohet nga lidhjet e gjakut si më sipër.

22.4 Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, nuk lejohet që ju të merrni pjesë ose të influenconi në procesin e ngritjes në përgjegjësi dhe të ngritjes së pagës së punonjësit me të cilin keni lidhje si më sipër, në procesin e dhënies së shpërblimeve, dhënies së të drejtave për kualifikime e specializime apo të dhënies së çdo përfitimi tjetër.

22.5 Ju jeni i detyruar të njoftoni Administratorët e Bankës së Shqipërisë, për rastet kur keni dijeni se në Bankën e Shqipërisë punojnë persona, me të cilët ju keni lidhje sipas përcaktimeve të mësipërme. Në këtë rast, Guvernatori mund të vendosë për transferimin e njërit prej tyre.

22.6 Nëse gjatë periudhës së punësimit në bankë krijohen lidhje gjinie ose krushqie si në raportet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ato i bëhen me dije administratorëve dhe Guvernatori mund të vendosë për transferimin ose jo të njërit prej tyre.

22.7 Nëse ju punoni në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, nuk ju lejohe të merrni pjesë në ekzaminimin e veprimtarisë së subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, kur këto veprimtari kryhen nga persona, me të cilët ju jeni në lidhje gjaku ose krushqie të afërt deri në raportet e përcaktuara sipas pikës “22.1” të këtij neni” (me personat që kontrollohen).

23. Zbatimi i orarit të punës

23.1 Ju duhet që, gjatë marrëdhënieve të punësimit në Bankën e Shqipërisë, të përdorni në mënyrë efektive kohën e punës për punën tuaj. Koha e punës nuk duhet përdorur për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar në përputhje me ligjet dhe me rregullat në fuqi.

23.2 Juve nuk duhet të kërkoni, të inkurajoni apo të lejoni që vartësit tuaj të përdorin kohën e punës për qëllime të tjera, përveç atyre që kërkon detyra e vendit tuaj të punës dhe për të cilat keni një autorizim sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.

23.3 Ju nuk duhet të përdorni postin tuaj për përfitime private, për mbështetjen e ndonjë produkti, shërbimi ose institucioni financiar privat, të miqve apo të personave të tjerë të lidhur në marrëdhënie gjaku deri në shkallën e dytë. Ju, gjithashtu, nuk duhet të përdorni postin tuaj për mbështetjen e personave me të cilët jeni lidhur privatisht (përfshirë këtu edhe subjektet jofitimprurëse) dhe ku ju bëni pjesë si edhe personat me të cilët ju keni ose kërkonte të krijoni marrëdhënie tregtare.

23.4 Nuk lejohet që ju të përdorni apo të lejoni përdorimin e pozicionit, të titullit tuaj zyrtar apo të çdo lloj autoriteti tjetër që lidhet me funksionin tuaj, në mënyrë të tillë që të nxisni ose të shtrëngoni ndonjë person tjetër, përfshirë edhe vartësit, që t'ju bëjnë ndonjë favor financiar (ose të ndonji lloji tjetër), juve ose miqve e personave me të cilët keni lidhje gjaku deri në shkallën e dytë, apo atyre me të cilët ju jeni lidhur jo zyrtarisht.

23.5 Nuk lejohet që ju të përdorni postin tuaj zyrtar për të penguar veprimtarinë e të tretëve ose për t'i dëmtuar ata për arsye personale.

24. Saktësia e llogarive dhe e regjistrimeve

24.1 Të gjitha llojet e llogarive kontabile të Bankës së Shqipërisë duhet të tregojnë me vërtetësi informacionin që ato pretendojnë se përfaqësojnë. Të gjitha regjistrimet e këtij lloji duhet të jenë konform politikave të Bankës së Shqipërisë dhe parimeve të kontabilitetit.

24.2 Personat e ngarkuar, janë përgjegjës për administrimin e të dhënave dhe korrigjimet e tyre si edhe për përdorimin e mjeteve dhe sistemeve të

informacionit të Bankës së Shqipërisë në përputhje të plotë me operacionet dhe me veprimtarinë e saj.

24.3 Regjistrimet e kohës janë një formë e veçantë regjistrimi. Është e rëndësishme të sigurohet një regjistrim i kujdesshëm i kohës për të gjithë punonjësit e stafit. Regjistrime kohe të papërshtatshme apo jo të plota mund të çojnë në vendime jo të sakta, të cilat sjellin dëmtimin e personave konkretë ose të Bankës së Shqipërisë.

25. Prokurimet

Metodat e brendshme të prokurimit dhe ato të përdorura nga partnerët dhe nga klientët e Bankës së Shqipërisë gjatë realizimit të projekteve të saj duhet të jenë të ndershme dhe transparente. Lidhur me to Banka e Shqipërisë i përmbahet zbatimit të politikave dhe udhëzimeve që kanë lidhje me procedurat e prokurimit. Banka e Shqipërisë ka përgjegjësinë që të sigurohet që realizimi i procedurave lidhur me prokurimet të mos rezultojë si favorizim.

26. Angazhim ndaj mjedisit

Ju duhet ta kryeni punën tuaj në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje me rregullat dhe dhe ligjet e zbatuara të mjedisit. Banka e Shqipërisë i kushton vëmendje të veçantë ndikimit që kanë veprimet e saj në ruajtjen e mjedisit. Banka e Shqipërisë ndjen përgjegjësinë që të ngrejë çështje dhe shqetësime lidhur me kushtet që konsiderohen të dëmshme për shëndetin dhe për sigurinë njerëzore apo për mjedisin.

27. Punësimi dhe kufizimet pas largimit nga Banka e Shqipërisë

27.1 Nëse ju jeni larguar apo jeni duke u larguar nga punësimi juaj në Bankën e Shqipërisë duhet që të respektoni rregullat përkatëse lidhur me përdorimin dhe me ruajtjen e informacionit. Në veçanti, nëse ju jeni duke u larguar nga Banka e Shqipërisë nuk duhet të përdorni apo të zbuloni informacione të rezervuara për të cilat ju jeni bërë me dije për shkak të postit që keni patur në Bankën e Shqipërisë si edhe nuk duhet të kontaktoni ish-kolegët tuaj me qëllim që të jepni informacione të rezervuara. Ju e keni të ndaluar që t'ju jepni informacione të rezervuara ish-kolegëve tuaj, të cilët që nga momenti i largimit të tyre nga Banka e Shqipërisë duhet të trajtohen si çdo palë tjetër e tretë jashtë mjedisit të saj.

27.2 Nëse ju jeni larguar nga punësimi në Bankën e Shqipërisë dhe gjatë marrëdhënieve të punësimit në të, keni marrë pjesë në ekzaminime të bankave të licencuara, në analizën dhe në përgatitjen e materialeve për probleme të veçanta, në prokurime për vlerësimin e ofertave dhe të tenderave, ndalohet që të kontaktoni në emër të punëdhënësit ku jeni punësuar, me Bankën e Shqipërisë për probleme që ju keni dijeni.

27.3 Nëse ju keni punuar në Departamentin e Mbikëqyrjes ose në atë të Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë, nuk lejohet që të punësoheni (pas largimit nga puna në Bankën e Shqipërisë) në bankat apo në institucionet e tjera financiare që në ndonjë mënyrë kanë patur të bëjnë me punën tuaj në Bankën e Shqipërisë, për një periudhë 3 (tre) mujore pas përfundimit të marrëdhënieve të punësimit.

28. Deklarimi i njohjes së detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i rregullave

Duhet që ju, çdo fillim viti, të plotësoni një deklaratë ku të shpreheni se i njihni dhe i zbatoni detyrimet e përcaktuara në këtë kod, si dhe detyrimet e tjera që përcaktohen në “Rregullat mbi marrëdhëniet e punës të personelit në Bankës e Shqipërisë”.

29. Publikimi dhe hyrja në fuqi

Kodi i Etikës i Bankës së Shqipërisë hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Shkëlqim Cani
GVERNATOR